



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

FLETINFORMACION

PËR ÇËSHTJEN

Numri i çështjes:
KSC-BC-2023-12

Prokurori i Specializuar kundër:



Hashim Thaçi



Bashkim Smakaj



Isni Kilajt



Fadil Fazliut



Hajredin Kuçit

Faza e çështjes:
PROCEDURË PARAPRAKE

TË AKUZUARIT/AKUZAT

HASHIM THAÇI

Datëlindja: 24/04/1968

- Gjatë periudhës që mbulon Aktakuza, Hashim Thaçi ishte në paraburgim në kontekst të gjykimit të tij në lidhje me akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve
- Ai ishte më parë udhëheqës i UÇK-së dhe anëtar themelues i Partisë për Progres Demokratik të Kosovës, e cila në vitin 2000 mori emrin Partia Demokratike e Kosovës ("PDK").
- Ai ka qenë edhe Kryeministër dhe President i Kosovës

BASHKIM SMAKAJ

Datëlindja: 01/07/1976

- Ishte më parë drejtor i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë dhe u punësua nga Presidenti i atëhershëm Hashim Thaçi nga viti 2017 deri në vitin 2020.

ISNI KILAJ

Datëlindja: 19/12/1963

- Ishte anëtar themelues i UÇK-së në Malishevë dhe ish-komandant i njësitit "Lumi".
- Ka qenë edhe kryetar i PDK-së së Thaçit në komunën e Malishevës

FADIL FAZLIU

Datëlindja: 15/07/1960

- Është veteran i UÇK-së i cili veproi në Zonën Operative të Llapit

HAJREDIN KUÇI

Datëlindja: 02/01/1971

- Ai ka punuar më parë në qeverinë e Presidentit të atëhershëm Thaçi, si zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë i Kosovës
- Gjatë periudhës që mbulon Aktakuza, Hajredin Kuçi ishte anëtar i ekipit të Mbrojtjes së Kadri Veselit (një i akuzuar tjetër në çështjen Thaçi dhe të tjerët).

Përshkrimi i akuzave

Sipas Aktakuzës së konfirmuar, së paku midis 12 prillit 2023 dhe 2 nëntorit 2023, gjatë vizitave jo të privileguara në objektin e paraburgimit, Hashim Thaçi u dha Smakajt, Kilajt, Fazliut dhe Kuçit informacion konfidencial në lidhje me dëshmitarë të ZPS-së, udhëzime për të ndikuar në dëshmitë e dëshmitarëve të ZPS-së dhe hollësi se si duhej ta bënin këtë.

Në aktakuzë më tej pretendohet se Thaçi bashkërendoi tri grupe të veçanta, të formuara me Smakajn, me Fazliun dhe me Kilajn, dhe persona të tjerë kundër të cilëve nuk janë ngritur akuza, si dhe me Kuçin, me synimin për të ndikuar në dëshmitë e dëshmitarëve të ZPS-së në kontekstin e gjykimit aktual për krime lufte Thaçi dhe të tjerët.

Format e përgjegjësisë

Tentativë për kryerjen e veprave penale (të gjithë të akuzuarit)

Marrëveshje për kryerjen e veprave penale (Thaçi, Kuçi)

Nxitje (Thaçi)

Ndihmë (Smakaj, Kilaj, Fazliu)

Akuzat

THAÇI: Pikat 1, 2 dhe 3, Tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (Vepra penale kundër rendit publik)

Pikat 4, 5, 6 dhe 7, Shkelje e fshehtësisë së procedurës (Vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike)

Pikat 8, 9, 10 and 11, Mosbindje ndaj gjykatës (Vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike)

SMAKAJ: Pika 12, Tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (Vepra penale kundër rendit publik)

Pika 13, Mosbindje ndaj gjykatës (Vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike)

KILAJ: Pika 14, Tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (Vepra penale kundër rendit publik)

Pika 15, Mosbindje ndaj gjykatës (Vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike)

FAZLIU: Pika 16, Tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (Vepra penale kundër rendit publik)

Pika 17, Mosbindje ndaj gjykatës (Vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike)

KUÇI: Pika 18, Mosbindje ndaj gjykatës (Vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike)

Pika 19, Mosbindje ndaj gjykatës (Vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike)

KRONOLOGJIA

Isni Kilaj u arrestua më 2 nëntor 2023 në Kosovë dhe u transferua në njësinë e paraburgimit të DHSK-së më 3 nëntor 2023. Seanca e paraqitjes së parë të Kilajt, si i dyshuar, para Gjykatës të Vetëm, u mbajt më 4 nëntor 2023, në bazë të nenit 41 të Ligjit dhe rregullës 55 të Rregullores. Në maj 2024, për shkak të vonesave të konsiderueshme të afatit të procedurave, Gjykatësi i Vetëm përcaktoi se zgjatja e paraburgimit të tij do të ishte e paarsyeshme dhe urdhëroi lirin e Kilajt në Kosovë me kushte të rrepta. Vendimi i Gjykatës të Vetëm u konfirmua në vijim nga Gjykata e Apelit e DHSK-së. Gjatë gjithë kësaj periudhe ai u konsiderua vetëm si i dyshuar.

Pas konfirmimit të Aktakuzës kundër pesë të akuzuarve, Isni Kilaj, Bashkim Smakaj dhe Fadil Fazliu u arrestuan nga ZPS-ja më 5 dhjetor dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) në Hagë më 6 dhjetor 2024. Hashim Thaçit iu dorëzua fletarrestimi në objektin e paraburgimit të DHSK-së më 5 dhjetor, ndërsa Hajredin Kuçit iu dorëzua fletëthirrja për paraqitjen e parë.

TË CAKTUAR NË KËTË ÇËSHTJE

GJYKATËSJA E PROCEDURËS PARAPRAKE



Gjykatëse Marzhori Maselo

ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR (PËRFAQËSUESIT KRYESORË)



Xhashua Hafec

MBROJTJA (MBROJTËSIT KRYESORË)



Sofi Menegon (për H. Thaçin)



Xhonëthën Ris (për B. Smakajn)



Ijan Edvards (për I. Kilajn)




David Young (për F. Fazliun)




Aleksander Admiral (për Hajredin Kuçin)

**Për më shumë informacion përdorni kamerën e telefonit tuaj
për të skanuar kodet e mëposhtme:**



Faqja e çështjeve gjyqësore




Kalendari i gjykatës



Faqja e aktualiteteve



Kanali Youtube i DSK-së



Profili X i DSK-së



Profili Instagram i DSK-së



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA



DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS / FLETINFORMACION PËR ÇËSHTJEN